



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 17, pika b dhe neni 40, pika l të Ligjit për vetëqeverisje lokale të Kosovës, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 5, paragrafi 1.2. nënparagrafi 1.2.1 dhe nenet 10, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafët 1.3 dhe 1.4 dhe nenit 15 të Ligjit për planifikim hapësinor nr. 04/L-174, datës 31.07.2013, si dhe Udhëzimit administrativ MMPH, nr. 11/2015, mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.03.2018, miratoi këtë

VENDIM

PËR

FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit zhvillimor të komunës së Prishtinës.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani zhvillimor komunal, në harmoni me ligjin, si plan strategjik shumësektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani zhvillimor i komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën tetë (8) vjeçare.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me Planin zhvillimor komunal nga neni 1 i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të

arritur kushte optimale dhe organizimin hapësinor të komunës së Prishtinës, plotëson kërkesat ligjore për të përgatitur Planin strategjik shumësektorial, i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

Neni 4

Kufiri i territorit

Zonat kadastrale në territorin e komunës së Prishtinës janë:

Nr.	Zona kadastrale	Shifra	Sipërfaqja në ha	Sipërfaqe në m ²
1	Hajkobillë	71907001	737,70,46	7377046
2	Hajvali	71914002	762,90,17	7629017
3	Ballaban	71912003	1 217,75,77	12177577
4	Barilevë	71902004	1 004,41,31	10044131
5	Besi	71914007	425,70,01	4257001
6	Busi	71914008	1633,68,74	16336874
7	Dabishec	71907024	1 093,32,61	10933261
8	Nëntë Jugoviq	71914021	515,54,71	5155471
9	Bërnice e Poshtme	71914024	839,42,69	8394269
10	Dragoc	71914030	922,98,46	9229846
11	Drenoc	71902031	251,62,47	2516247
12	Glllogovicë	71907014	811,54,13	8115413
13	Bërnice e Epërme	71914013	830,76,87	8307687
14	Grashticë	71914020	1 496,26,87	14962687
15	Keçekollë	71912037	3 672,51,56	36725156
16	Kolovicë	71914034	718,39,61	7183961
17	Koliq	71912039	3 985,30,82	39853082
18	Kukavicë	71914039	443,90,88	4439088
19	Lebanë	71914043	218,16,31	2181631
20	Llukar	71914045	746,63,55	7466355
21	Makoc	71914047	1 136,60,96	11366096
22	Marec	71903041	7 270,83,97	72708397
23	Matiçan	71914050	722,15,72	7221572
24	Mramor	71914052	3 777,17,80	37771780
25	Nishec	71912056	1 115,04,38	11150438
26	Novosellë	71914054	935,92,98	9359298
27	Orlloviq	71914056	188,37,53	1883753
28	Prishtinë	71914059	3 053,69,91	30536991
29	Prapashticë	71912066	2 212,58,67	22125867
30	Prugoc	71914060	396,96,94	3969694
31	Radashec	71914061	761,12,52	7611252
32	Rimanishtë	71914063	1 384,31,98	13843198
33	Sharban	71912083	1 299,07,31	12990731

34	Shashkoc	71909091	234,20,89	2342089
35	Siqevë	71914064	709,31,88	7093188
36	Slivovë	71914065	709,70,18	7097018
37	Sofali	71914066	771,79,02	7717902
38	Tenezhdoll	71914069	246,11,49	2461149
39	Trudë	71914070	587,27,41	5872741
40	Vranidoll	71914012	740,22,53	7402253
41	Zllatar	71914032	845,63,57	8456357
42	Cagllavicë	71914073	892,55,07	8925507

Gjithsej

52 319,30,70 ha

523 193 070 m²

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të planit është Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor janë të siguruara nga buxheti i Komunës së Prishtinës. Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, koordinon procesin e hartimit të Planit zhvillimor komunal me drejtoritë sektoriale dhe ekipi konsulent mbështetës.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi, është i obliguar që Planin zhvillimor komunal ta hartojë në afat për 12 (dymbëdhjetë) muaj, që nënkupton kompletimin e dokumentacionit për prezantim në procesin e konsultimeve publike, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Konsultimet publike

Projekti i Planit zhvillimor komunal para finalizimit, duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Projektplanit zhvillimor komunal në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallet përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i vlefshmërisë

Dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani zhvillimor komunal, hartohet për periudhën kohore 8 (tetë) vjeçare.

Neni 10

Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi, duhet të jetë në gjuhë zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11

Programi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë sipas nenin 11, pika 1.3 të Ligjit për planifikim hapësinorë, nr. 04/L-174.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01-350/05-57601/18, më 09.03.2018

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Agim Kuleta






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

HARTIMI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL I PRISHTINËS



Plani Zhvillimor Komunal është plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani zhvillimor i Komunës përfshinë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën së paku 8 vjeçare.

Komuna e Prishtinës me Vendimin 01 nr.031-156871 dt. 27.08.2013 ka miratuar Planin Zhvillimor Komunal i Prishtinës 2012-2022.

Në vitin 2013 është aprovuar Ligji i ri për Planifikim Hapësinor Nr.04/L174, i cili parasheh në nivelin lokal këto dokumente: Planin Zhvillimor Komunal, Hartën Zonale të Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme.

Plani Zhvillimor Komunal përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik mbi të cilat bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës.

Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, ka përcaktuar përmbajtje shtesë andaj Planit Zhvillimor Komunal i Prishtinës 2012-2022 duhet të harmonizohet sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L174.

Në vijim janë të përshkruara hapat dhe procedurat për hartimin e këtij dokumenti:

PROGRAMI PËR HARTIMIN DHE MENAXHIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL I PRISHTINËS

I Punët parapërgatitore				
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë
1	Përcaktimi i Komitetit Drejtues dhe grupit punues	Përcaktimi i udhëheqësit komunal të projektit, koordinatoreve të drejtorive (KD) dhe zyrtarët përkatës	Përcaktimi i Grupit Punues	1
2	Përcaktimi i grupeve të interesit	2.1) Përcaktimi i grupeve lokale të interesit - Institucionet në nivelin qendror; - Organizatat e Jashtme që ofrojnë shërbime publike; - OJQ; - Biznese; - Përfaqësues nga Bashkësitë Lokale. 2.2) Krijimi i listës dhe kontakteve të pjesëmarrësve	Në mënyrë që procesi të jetë sa më transparent dhe gjithëpërfshirës	1
3	Hartimi i konceptit dhe planit të punës	3.1) Shqyrtimi i Legjislacionit në fuqi, 3.2) Vlerësimi i PZHK-së paraprake 3.3) Analizim i PHK'ës që përcakton zhvillimet për komunën 3.4) Krijimi i strukturës përmbajtjesore 3.5) Prezantimi i strukturës së dokumentit dhe konceptit të punës para drejtorive komunale	Koordinimi i qëndrueshëm i drejtorive komunale, Planit i hollësishëm i punës gjatë procedurës së hartimit të PZHK-së	1
				Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

II Grumbullimi dhe vlerësimi i të dhënave nga Drejtoritë Komunale				
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë
1	Grumbullimi i të dhënave në nivelin lokal	Grumbullimi i të dhënave nga Drejtoritë Komunale	Përbushja e kërkesave të kërkuara nga UA për PZHK	3
2	Grumbullimi i të dhënave në nivelin qendror dhe regional	Sigurimi i të dhënave nga Ministrinë përkatëse dhe institucionet përkatëse si (KEDS, UR etj.)	Përbushja e kërkesave të kërkuara nga UA për PZHK	2
				Udhëheqësi Komunal i Projektit

3	Vlerësimi i të dhënave	Vlerësimi i këtyre të dhënave dhe formatizimi i tyre sipas UA për PZHK.	Në mënyrë që të dhënat të jenë në përputhje me kërkesat ligjore nevojitet një vlerësim i plotësimi të këtyre kërkesave	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
4	Inkorporimi i të dhënave shpesh	Plotësimi me të dhëna shpesh, në rast se është e nevojshme	Të gjitha të dhënat e grumbulluara të jenë sipas UA për PZHK	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

III Përgatitja e Profilit					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Përpilimi i përmbajtjes tekstuale dhe hartografike	1.1) Profili i të dhënave do të përmbajë -Historiku i zhvillimit; -Pozita; -Gjendja ekzistuese demografike; -Gjendja ekzistuese e veçorive mjedisore; -Gjendja ekzistuese e zhvillimit ekonomike; -Gjendja ekzistuese e infrastrukturës teknike; -Gjendja e infrastrukturës së transportit dhe transporti publik; -Gjendja ekzistuese e infrastrukturës publike; -Gjendja ekzistuese e infrastrukturës sociale; -Gjendja ekzistuese e mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri; -Gjendja ekzistuese e aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike; -Gjendja ekzistuese e vendbanimeve; -Gjendja ekzistuese e shfrytëzimit të tokës.	Inkorporimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese/faktike për planifikim të mëtejshëm	3	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

2	Vlerësimi i Profilit	2.1) Vlerësimi i Profilit nga KD 2.2) Vlerësimi i Profilit nga GD 2.3) Vlerësimi i Profilit nga ekiye konsulent/mbështetëse 2.4) inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve	Përbusha e kërkesave të përcaktuara sipas UA për PZHK	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekip konsulent/mbështetës
3	Shqyrtimi Publik	3.1 Përgatitja e prezantimit të Profilit Komunal për shqyrtim Publik 3.2 Zhvillimi i shqyrtimeve publike të profilin	Në mënyrë që të plotësohet Profili me të dhëna e fundit është i nevojshëm prezantimi publik	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit
4	Plotësimi dhe përfundimi i profilin komunal	Inkorporimi i komenteve apo sugjerimeve nga banorët	pasurim i të dhënave faktike dhe sensibilizimi i banorëve për hapat e mëtejshëm	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekip konsulent/mbështetës

IV Përgatitja e Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Përpilimi i përmbajtjes tekstuale dhe hartografike të Profilit të Komunës	1.1) Vlerësimi i gjendjes ekzistuese në raport me synimet e qeverisjes qEndrore dhe standardeve hapësinore si vijon: -Gjendja ekzistuese e zhvillimit ekonomik; -Gjendja ekzistuese e infrastrukturës teknike; -Gjendja e infrastrukturës së transportit dhe transporti publik; -Gjendja ekzistuese e infrastrukturës publike; -Gjendja ekzistuese e infrastrukturës sociale; -Gjendja ekzistuese e mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri; -Gjendja ekzistuese e aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike; -Gjendja ekzistuese e vendbanimeve; -Gjendja ekzistuese e shfrytëzimit të tokës.	Inkorporimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese/faktike për planifikim të mëtutjeshëm	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe konsulent/mbështetës
2	Konsultimi i Vlerësimit të gjendjes Ekzistuese nga Grupet Punuese	2.1) Shqyrtimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese nga KD; 2.2) Shqyrtimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese nga GP; 2.3) Shqyrtimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese nga ekipi konsulent/mbështetës; 2.4) Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve	Prezantimi Publik i Vlerësimit të gjendjes ekzistuese	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
3	Shqyrtimi Publik	Përgatitja dhe prezantimi i shqyrtimit publik për vlerësimin e Gjendjes Ekzistuese	Plotësimi dhe përfundimi i vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
4	Vlerësimi Strategjik Mjedisor - Pasqyra	Përcjellja e Profilit Komunal tek Konsulenti Mbatja e takimeve sipas nevojës (sektori për Mjedis)	Përmbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të PZHK-së		Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe Sektori për Mjedis

V Përgatitja e SWOT Analizës, Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Zhvillimi i punëve për caktimin e SWOT Analizës, Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike	1.1) Përcaktimi i agjendës dhe pjesëmarrësve në punëtori 1.2) Përcaktimi i SWOT analizës të gjendjes ekzistuese për: -Gjendja ekzistuese e Zhvillimit Ekonomik; -Gjendja ekzistuese e infrastrukturës teknike; -Gjendja e infrastrukturës së transportit dhe transporti publik; -Gjendja ekzistuese e infrastrukturës publike; -Gjendja ekzistuese e infrastrukturës sociale; -Gjendja ekzistuese e mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri; -Gjendja ekzistuese e aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike; -Gjendja ekzistuese e vendbanimeve; -Gjendja ekzistuese e shfrytëzimit të tokës. 1.3) Përcaktimi i Vizionit dhe Qëllimeve; 1.4) Përcaktimi i Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike për Zhvillimin; - Ekonomik -infrastrukturës së transportit dhe transporti publik; -infrastrukturës publike; -infrastrukturës sociale; -Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri; -Aseteve të Trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike; -Vendbanimeve; -Shfrytëzimit të tokës.	Përmes SWOT analizës përcaktohen mundësit për gjetjen e një skenari më të favorshëm	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
2	Përgatitja e Kornizës së Zhvillimit Hapësinor	2.1) Përgatitja e Kornizës së Zhvillimit Hapësinor dhe Skenarëve të mundshëm; 2.2) Shqyrtimi i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor nga KD; 2.3) Shqyrtimi i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor nga GP; 2.4) Shqyrtimi i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor nga ekipi konsulent/mbështetës; 2.5) inkuorporimi i komenteve dhe sugjerimeve	Përmes skenarëve zhvillimor përcaktohet planifikimi i mëtejshëm	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

3	Shqyrtimi i Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës Zhvillimore Hapësinore	3.1) Përgatitja e Shqyrtimit Publik të Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës Zhvillimore Hapësinore 3.2) Zhvillimi i shqyrtimeve publike të Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës Zhvillimore Hapësinore	Përfshirja e qytetarëve në procesin e planifikimit	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
4	Inkorporimi i Komenteve	inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga banorët		2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

VI Përgatitja e Planit të Veprimit Dispozitive, për Zbatim dhe Monitorim					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjësi
1	Përgatitja e Planit të Veprimit, Dispozitive për Zbatim dhe Monitorim	1.1) Përcaktimi i Planit të Veprimit, Dispozitive për Zbatim dhe Monitorim për arrijen e qëllimeve dhe objektive në fushën: -Ekonomike -infrastrukturës së transportit dhe transporti publik; -infrastrukturës publike; -infrastrukturës sociale; -Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri; -Asateve të Trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike; -Vendbanimeve; -Shfrytëzimit të tokës.	Për një planifikim të qëndrueshëm, nevojitet që të zhvillohet një punëtori në KD, punonjës të drejtorive të ndryshme komunale dhe pjesëtarë të tjerë të GP.	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
2	Shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitive për Zbatim dhe Monitorim	2.1) Shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitive për Zbatim dhe Monitorim nga KD; 2.3) Shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitive për Zbatim dhe Monitorim nga GP; 2.4) Shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitive për Zbatim dhe Monitorim nga ekipi konsulent/mbështetës; 2.5) Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve.	Për përcaktimin e veprimeve sipas planeve të drejtorive komunale dhe kornizës kohore nevojitet shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitive për Zbatim dhe Monitorim	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

3	Plotësimi dhe përfundimi i Planit të Veprimit, Dispozitive për Zbatim dhe Monitorim	Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
---	---	---	---	---

Konsolidimi dhe përfundimi i përmbajtjes së PZHK-së					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Konsolidimi dhe përfundimi i përmbajtjes së PZHK-së	1.1) Përfundimi i kapitullit të sfondit 1.2) Konsolidimi i tërë dokumentit	Përbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të PZHK-së	3	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
2	Dorëzimi i PZHK-së në MMPH për vlerësimin e përmbajtjes para organizimit të shqyrtimit publik	2.1) Dorëzimi përfundimtar i PZHK-së në MMPH; 2.2) Përgatitja dhe organizimi i prezantimit të draftit përfundimtar të PZHK-së në MMPH; 2.3) Vlerësimi nga MMPH'ja për iniciimin e shqyrtimit publik të draftit përfundimtar të PZHK-së.	Përbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të PZHK-së	4	Udhëheqësi Komunal i Projektit

VIII Shqyrtimi Publik i PZHK-së					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Vendimi për Zhvillimin e Shqyrtimit Publik	3.1 Përgatitja e Vendimit për Shqyrtim Publik 3.2 Njoftimi publik përmes Gazetës Zyrtare dhe mediave siç e parasheh UA për pjesëmarrjen e publikut në shqyrtime publike	Përbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të PZHK-së	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit
3	Organizimi i Shqyrtimit Publik	3.1) Hapja Zyrtare e Shqyrtimit Publik dhe Prezantimi publik i draftit të parë 3.2) Ekspozimi i draftit 3.3) Pranimi i komenteve nga qytetarët	Planifikim transparent dhe gjithëpërfshirës	4	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe sektori për Planifikim

4	Raporti i Shqyrtimit Publik	Përgatitja e Raporti të Shqyrtimit Publik	Përbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të PZHK-së	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe Komisioni
5	Inkorporimi i vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve	Ndryshimi, plotësimi, harmonizimi i PZHK-së në përputhje me vërejtjet, komentet dhe sugjerimet	Përbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të PZHK-së	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

IX Miratimi i PZHK-së					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Miratimi i PZHK-së nga MMPH'ja	1.1) Dorëzimi i PZHK-së për miratim në MMPH 1.2) inkorporimi i vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve nga MMPH'ja; 1.3) Miratimi i PZHK-së nga MMPH'ja	Përbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të PZHK-së	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit
2	Miratimi i PZHK-së nga Kuvendi Komunal	2.1) Dorëzimi i PZHK-së për miratim në Kuvendin Komunal 2.2) inkorporimi i vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve nga Kuvendi Komunal, në rast se ka; 2.3) Miratimi i PZHK-së nga MMPH'ja.	Përbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të PZHK-së	2	Kryetari i Komunës dhe Kuvendi Komunal

Vërejtje: Gjatë këtyre procedurave të Planit Zhvillimor Komunal i Prishtinës, planifikohen të mbahen, sipas nevojës, takime me Komitetin Drejtues.

KOMUNA E PRISHTINËS - PARCELAT ME ORTOFOTO



Zonat Kadastrale

1. Ballaban
2. Barilevë
3. Besi
4. Busi
5. Bërnice e Epërme
6. Bërnice e Poshtme
7. Dabishec
8. Dragoc
9. Drenoc
10. Glogovicë
11. Grashitë
12. Hajkobillë
13. Hajvali
14. Keqekollë
15. Koliq
16. Kolovicë
17. Kukavicë
18. Lebanë
19. Llutar
20. Makoc
21. Marec
22. Matçan
23. Mramor
24. Nishec
25. Novosellë
26. Nëntë Jugoviq
27. Orlovicë
28. Prapashticë
29. Prishtinë
30. Prugoc
31. Radashec
32. Rimanishtë
33. Sharban
34. Shashkoc
35. Siçevë
36. Slivovë
37. Sofali
38. Tenezhdoll
39. Trudë
40. Vranidoll
41. Zllatar
42. Çagllavicë